



► Vlerësimi i nevojave të ndërmarrjeve si pasojë e COVID-19

► Data: Prill 2020

Ky instrument synon të mbështesë organizatat e anëtarësimin të punëdhënësve dhe biznesit (OAPB) për të vlerësuar nevojat e ndërmarrjeve që lindin si pasojë e krizës së shkaktuar nga COVID-19. Ai përbëhet nga dy pjesë: (1) një anketë për vlerësimin e nevojave, dhe (2) një formular model për të paraqitur gjetjet kryesore dhe për të kërkuar ndihmë nga autoritetet, bankat, etj.

Anketa për vlerësimin e nevojave i ndihmon OAPB-të për të kryer një ekzaminim fillestar të ndikimit të COVID-19 tek ndërmarrjet dhe tek aktiviteti i tyre. OAPB-të mund ta përdorin këtë anketë për të kuptuar më mirë çështjet e mëposhtme:

- Cilat lloje të ndërmarrjeve po preken më shumë nga COVID-19 (të vogla, të mesme, të mëdha)?
- Cilët sektorë po preken më shumë nga COVID-19?
- Cilat rajone gjeografike po preken më shumë?
- Cila është gjendja aktuale e aktivitetit të biznesit (i hapur, punon në distancë nga shtëpia apo i mbyllur)?
- A po përjetojnë ndërmarrjet rënie të madhe të kërkesës për produktet / shërbimet kryesore?
- Cilat janë sfidat më të ngutshme me të cilat po përballen ndërmarrjet (p.sh. fluksi i parave, personeli, ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit, kërkesa më e ulët)?
- A krijojnë këto sfida pengesa për të për ushtrimin e aktivitetit të biznesit për një periudhë afatshkurtër dhe / ose afatgjatë?

- Cili është ndikimi financiar në ndërmarrje?
- A mund të qasen ndërmarrjet tek huatë ose grantet për të mbështetur rimëkëmbjen e biznesit?
- A janë duke e menduar pronarët e bizneseve mundësinë e mbylljes së biznesit të tyre?
- Cilat janë masat proaktive të ndërmarra nga bizneset për të mbështetur vazhdimësinë e operacioneve ditore ndërkohë që garantojnë edhe mbrojtjen e punëtorëve?

Ky formular model synon të përdorë gjetjet kryesore nga përgjigjet e anketës për të nxjerrë në pah sfidat kryesore që po përjetojnë ndërmarrjet për shkak të COVID-19. Duke vlerësuar përgjigjet e anketës, OAPB-të mund të identifikojnë nevojat dhe përparësitë kryesore të ndërmarrjeve që duhen adresuar. Kjo do t'i ndihmojë OAPB-të për të kërkuar ndihmë që i përgjigjet nevojave aktuale të ndërmarrjeve, duke përfshirë edhe grantet qeveritare, kreditë me interes të ulët dhe masat për lehtësimin e taksave për sektorët që janë prekur më shumë.

Si vlerësimi i nevojave të ndërmarrjes ashtu dhe formulari model janë të adaptueshëm dhe OAPB-të mund t'i modifikojnë ato në varësi të objektivave të tyre, nevojave të ndërmarrjeve dhe sfidave specifike për periudhën që pason COVID-19.

Anketa për vlerësimin e nevojave: Ndikimi i COVID-19 tek ndërmarrjet

[Emri i OAPB-së] është duke kryer një anketim të ndërmarrjeve për të kuptuar situatën dhe sfidat tuaja për shkak të krizës së vazhdueshme të shkaktuar nga COVID-19. Ne do të përdorim përgjigjet e anketës për të kanalizuar shqetësimet tuaja tek autoritetet qeveritare, bankat dhe palët e tjera të interesit si dhe për të ndryshuar shërbimet tona për ju. Informacioni i ofruar nga ju do të ruhet në mënyrë konfidenciale. Ju nevojiten 10 minuta kohë në dispozicion për plotësimin e anketës. Ju falënderojmë për mbështetjen tuaj gjatë këtyre kohërave të vështira - ne jemi plotësisht operacionale gjatë pandemisë dhe do të vazhdojmë të ofrojmë shërbimet tona për ju.

Emri dhe pozicioni i të anketuarit

Numri i celularit dhe adresa e postës elektronike

Emri i ndërmarrjes

Vendndodhja (Qyteti)

1. Numri i përgjithshëm i punonjësve para përhapjes së COVID-19 (me kohë të plotë, me kohë të pjesshme dhe të përkohshëm):

- 1-10 11-100 101-250 251 ose më shumë
-

2. Sektori/ sektorët e aktivitetit:

- | | |
|---|--|
| <input type="checkbox"/> bujqësi / blegtori / peshkim | <input type="checkbox"/> Fabrikim dhe makineri për produkte metali |
| <input type="checkbox"/> kimikate dhe plastikë | <input type="checkbox"/> miniera dhe rafinim |
| <input type="checkbox"/> ndërtim | <input type="checkbox"/> naftë dhe gaz |
| <input type="checkbox"/> arsim | <input type="checkbox"/> aktivitete të pasurive të patundshme |
| <input type="checkbox"/> pajisje elektronike dhe elektrike | <input type="checkbox"/> restorante |
| <input type="checkbox"/> aktivitete financiare ose të sigurimit | <input type="checkbox"/> shitjet me pakicë |
| <input type="checkbox"/> ushqim dhe pije | <input type="checkbox"/> tekstile, lëkure dhe veshje |
| <input type="checkbox"/> produkte pyjore / druri / letre | <input type="checkbox"/> transport dhe pajisje transporti |
| <input type="checkbox"/> informacion dhe komunikim | <input type="checkbox"/> tjetër, ju lutemi specifikoni |
| <input type="checkbox"/> hoteleri/turizëm | |
-

3. A është ndërmarrja juaj aktualisht në veprim?

- plotësisht në ambientet e saj
 pjesërisht
 plotësisht, por në distancë (*teleworking*)
 jo operacionale
-

4. A keni larguar nga puna apo a keni ndërmend të largoni ndonjë punonjës për shkak të COVID-19?

- Po
 Jo
-

4.1 Nëse po, cila është përqindja e punonjësve të larguar? Përcaktoni përqindjen e punonjësve të pushuar në krahasim me fuqinë tuaj totale të punës.

- 1-10%
 21-30%
 Mbi 41%
 11-20%
 31-40%
-

5. A ka ndërmarrja juaj një plan të shkruar për vazhdimësinë e biznesit?

- Po
 Jo

6. A është ndonjë nga punonjësit tuaj apo familjarët e tyre të infektuar nga COVID-19?

- Po
 Jo
-

7. A ka ndërmarrja juaj qasje adekuate tek solucionet higjienizuese dhe pajisjet dhe produktet e tjera mbrojtëse personale?

- Po
 Jo
-

8. A keni ndryshuar operacionet e biznesit tuaj ose ofrimin e shërbimeve për të mbrojtur ndërmarrjen tuaj nga COVID-19?

- Po
 Jo
-

9. Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballet ndërmarrja juaj aktualisht si rezultat i COVID-19?

- Po
 Jo
- ▶ Fluksi i parave për të mirëmbajtur stafin dhe operacionet e biznesit është i pamjaftueshëm. Po Jo
 - ▶ Punonjësit nuk paraqiten në punë për shkak të sëmundjes ose urdhrave të qeverisë. Po Jo

- ▶ Nuk kemi lëndë të para rezervë ose janë shtrenjtuar shumë për shkak të situatës. Po Jo
- ▶ Furnitorët nuk janë në gjendje të sigurojnë input-et. Po Jo
- ▶ Partnerët e biznesit janë prekur seriozisht dhe nuk funksionojnë normalisht. Po Jo
- ▶ Konsumatorët / klientët janë prekur dhe kërkesa është më e ulët se normalja. Po Jo
- ▶ Të tjera, ju lutemi specifikoni.
-

10. A ka qenë biznesi juaj plotësisht, pjesërisht apo i pa siguruar para se të ndodhte kriza e shkaktuar nga COVID-19?

- Plotësisht Pjesërisht Aspak

10.1 Nëse po, çfarë lloj sigurimi ka patur biznesi juaj?

11. Cili ka qenë niveli i efektit financiar (të ardhurat ose shitjet) në biznesin tuaj dhe niveli i dëmtimit të operacioneve të biznesit (i lartë, i mesëm, i ulët, jo e aplikueshme)?

- I lartë I mesëm I ulët N/A
-

12. A keni fonde vetjake (p.sh. para të gatshme, kursime) ose qasje tek burimet alternative / të jashtme (p.sh. hua ose grante) të financimit për të ndihmuar biznesin të rimarrë veten?

- Po Jo

12.1 Nëse po, a është i mjaftueshëm ky financim?

- Po Jo
-

13. Sa kohë do t'i duhej ndërmarrjes suaj që të rikuperonte plotësisht operacionet e saj?

- Më pak se 7 ditë 91 deri në 180 ditë
- 8 deri në 30 ditë Më shumë se 181 ditë
- 31 deri në 90 ditë Jam duke parë mundësinë e mbylljes së aktivitetit përkohësisht ose përgjithmonë
-

14. A keni ndonjë koment shtesë në lidhje me nevojat tuaja më të ngutshme?

- 15. A keni ndonjë shembull të praktikës më të mirë në lidhje me mënyrën e reagimit të ndërmarrjes tuaj ndaj COVID-19? Ju lutemi përshkruani ose ndani me ne një link në lidhje me punën tuaj.**
-

Formulari model për analizën e nevojave të ndërmarrjes për të kërkuar ndihmë

[Logoja e OAPB-së]

[Emri i OAPB-së]

Deklaratë nga

[Vendosni emrin e OAPB-së]

Kriza COVID-19 ka prekur ndjeshëm ndërmarrjet në [shënoni emrin qytetit ose shtetit].

Duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm që luajnë bizneset për hapjen e vendeve të punës, rritjen ekonomike, zhvillimin dhe përparimin, [shënoni emrin e OAPB-së] ka kryer një anketim për vlerësimin e nevojave për të identifikuar sfidat kryesore me të cilat përballen bizneset për shkak të COVID-19.

Kjo anketë u krye me [shënoni numrin e ndërmarrjeve] ndërmarrje në [shënoni vendndodhjen/vendndodhjet]. Ndërmarrjet e anketuara ishin pjesë e shumë sektorëve, duke përfshirë [emri të gjithë ose disa sektorëve] dhe të punësuarit nga [shënoni numrin minimal të punonjësve] dhe [shënoni numrin maksimal të punonjësve] punonjës.

Sa i përket gjendjes aktuale të ndërmarrjeve, anketa jonë për vlerësimin e nevojave ka identifikuar sa vijon:

- ▶ [Vendosni përqindjen e ndërmarrjeve] përqind e ndërmarrjeve të anketuara kanë ndërprerë aktivitetin e tyre për shkak të COVID-19. Ndërmarrjet më të prekura ishin kryesisht [zgjidhni një: të vogla, të mesme ose të mëdha], me [shënoni numrin e punonjësve] punonjës nga sektorët [emërtoni sektorët].
- ▶ Rreth [shënoni përqindjen e ndërmarrjes] përqind e ndërmarrjeve kanë qenë të detyruara për të pushuar stafin e tyre.

Problemet kryesore me të cilat po përballen ndërmarrjet aktualisht përfshijnë [zgjidhni ose fshini problemet kryesore sipas rastit]:

- ▶ [zgjidhni një: Shumica, Një pjesë e konsiderueshme] e ndërmarrjeve, [shënoni përqindjen e ndërmarrjes] përqind, deklaruan se fluksi i kufizuar i parave i ka penguar për rikuperimin e e plotë të operacioneve të tyre. Përveç kësaj, [shënoni përqindjen e ndërmarrjeve] përqind e ndërmarrjeve thanë që ata nuk kishin as fonde vetjake dhe as qasje tek burimet alternative të financimit për të ruajtur operacionet dhe nivelin e personelit.
- ▶ Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve, [shënoni përqindjen e ndërmarrjeve] përqind raportuan që operacionet e tyre ishin ndikuar negativisht, ku [vendosni përqindjen e ndërmarrjes] përqind e ushtrijnë aktivitetin e tyre me kapacitet [të ulët ose të reduktuar].
- ▶ Ndërprerja e zinxhirëve të furnizimit është një problem tjetër kyç që ka prekur bizneset. [shënoni përqindjen e ndërmarrjes] përqind e ndërmarrjeve kanë raportuar që furnitorët nuk ishin në gjendje të përballonin porositë; dhe [shënoni përqindjen e ndërmarrjeve] përqind thanë që partnerët e tyre të biznesit ishin prekur ndjeshëm nga COVID-19.

Ne i pyetëm ndërmarrjet tona nëse kanë qenë të siguruara pjesërisht apo plotësisht para krizës COVID-19. Vetëm [shënoni përqindjen e ndërmarrjeve] përqind e ndërmarrjeve të anketuara kishin policë sigurimi. Ne i pyetëm ndërmarrjet tona edhe nëse ata kishin patur një plan për vazhdimësinë e biznesit (PVB) para krizës së shkaktuar nga COVID-19. Vetëm [shënoni përqindjen e ndërmarrjeve] përqind e ndërmarrjeve të anketuara kishin hartuar PVB-në. Ky është një fakt shqetësues dhe mund të vonojë ndjeshëm procesin e rimëkëmbjes për shumë ndërmarrje.

Dhe e fundit anketa jonë zbuloi se pronarët e bizneseve prisnin që kriza të zgjaste mesatarisht [vendosni numrin e javëve ose muajve] dhe se nuk ka gjasa që ata të jenë në gjendje të rikuperojnë plotësisht operacionet / shitjet në nivelet e para krizës, ku [vendosni përqindjen e ndërmarrjeve] përqind e ndërmarrjeve janë duke parë mundësinë e mbylljes së aktivitetit qoftë përkohësisht ose përgjithmonë. Ndikimi në ekonominë e përgjithshme mund të jetë i konsiderueshëm nëse nuk merren masa me kohë për vazhdimësinë e biznesit.

Për pasojë, [shënoni emrin e OAPB-së] beson se masat e mëposhtme do të jenë thelbësore për të ndihmuar ndërmarrjet, punonjësit dhe familjet e tyre të përballen me sfidat që vijnë nga COVID-19 [zgjidhni ose fshini propozimet sipas kontekstit]:

- ▶ **Grantet qeveritare:** Ndërmarrjet e prekura në rëndë kanë nevojë për grante në para për të paguar punonjësit e tyre. Grantet qeveritare për ndërmarrjet duhet të mbulojnë [shënoni shumën dhe monedhën] për punonjës për [numër] javë / muaj.
- ▶ **Kredi me interes të ulët:** [shënoni institucionin përgjegjës qeveritar, p.sh. Ministria e Financave] duhet të lejojë pronarët e bizneseve nga [vendosni sektorin ose industrinë] që të kenë qasje tek kreditë me interes të ulët.
- ▶ **Trusti publik-privat për rimëkëmbjen nga COVID-19:** Ne besojmë se [shënoni agjencinë kryesore për zhvillimin ekonomik ose zhvillimin e biznesit], duhet të krijojë një trust për mbledhjen e donacioneve nga aktorët publik dhe privat në mënyrë që të sigurojë ndihmë për ndërmarrjet për [shënoni numrin] muaj.
- ▶ **Masat për lehtësimin e taksave në sektorët e goditur më rëndë:** Edhe ne besojmë që ndërmarrjet në [vendosni sektorët] duhet të lehtësohen në mënyrë të përkohshme nga taksat për [shënoni numrin e javëve / muajve]. Ndërmarrjet në këta sektorë kërkojnë mbështetjen tonë më të madhe për rimëkëmbjen duke marrë parasysh nivelin e dëmtimit që kanë pësuar.

Praktikat më të mira të kompanisë për të promovuar vazhdimësinë e biznesit dhe për të mbrojtur punonjësit

[Logoja e OAPB-së]

[Emri i OAPB-së]

Një studim rasti për praktikat e mira të biznesit në përgjigje të COVID-19

[Vendosni emrin e kompanisë]

Pandemia e COVID-19 ka patur një ndikim të pashembullt tek bizneset dhe punonjësit në të gjithë botën, ku [shënoni emrin e qytetit ose shtetit] aktualisht është kthyer në një pikë kritike. Në këtë kohë, punëdhënësit janë përballur me sfidën e vështirë për të ruajtur bizneset e tyre përballë rënies ekonomike, ndërkohë që kujdesen edhe për mirëqenien e punonjësve të tyre. Ndërkohë që kohët e fundit janë bërë të njohura masat mbështetëse të politikave siç janë [përmendni disa masa kryesore që janë shpallur], ritmi dhe shkalla e rënies ekonomike globale tashmë ka bërë që shumë biznese të zbatojnë në mënyrë proaktive masa të tilla si puna nga shtëpia, oraret e alternuara, madje edhe distancimi social, për të siguruar shëndetin e punonjësve të tyre dhe për të parandaluar përhapjen e sëmundjes në vendet e tyre të punës. Duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm që luajnë bizneset për krijimin e vendeve të punës, rritjen ekonomike, zhvillimin dhe përparimin, [shënoni emrin e OAPB-së] i ka ftuar kompanitë anëtare të ndajnë disa nga praktikat e tyre më të mira me qëllim:

[vendosni emrin e kompanisë, një përshkrim të shkurtër të biznesit, dhe bëni pak historik për disa nga efektet e para të përjetuara dhe kohën kur filluan të merrnin masa]. Si përgjigje, [shënoni emrin e kompanisë] që atëherë ka zbatuar masat e mëposhtme:

- ▶ [vendosni masën e politikës së ndërmarrjes]
- ▶ [vendosni masën e politikës së ndërmarrjes]
- ▶ [vendosni masën e politikës së ndërmarrjes]

► Kontakt

ILO Byroja për Aktivitetet e Punëdhënësve (ACT/EMP)
4, route des Morillons
Genève 22, Switzerland, CH-1211
E: actemp@ilo.org
W: www.ilo.org/actemp